

# FAKTE PËR EURON



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



# HYRJE

Euro është monedha zyrtare për 19 nga 27 vendet anëtare të BE-së. Një rrugë e gjatë përgatitore prej mbi 40 vjetësh çoi në hyrjen e euros në vitin 2002. Euro gjithashtu përdoret edhe në shtete të cilat nuk janë pjesë e Unionit Evropian siç janë: Kosova dhe Mali i Zi.



# SIMBOLI

Simboli dhe emri "euro" u zgjodhën në vitin 1995 në një takim të Këshillit Evropian në Madrid.

Simboli € bazohet në shkronjën greke epsilon (€), me shkronjën e parë në fjalën "Evropë" dhe me 2 vija paralele që tregojnë **stabilitet**. Kodi ISO për euron është EUR. Kjo përdoret kur i referohemi shumave të euros pa përdorur simbolin.



# BANKA QENDRORE EVROPIANE

Banka Qendrore Evropiane (BQE) dhe Komisioni Evropian, janë përgjegjës për ruajtjen e vlerës dhe stabilitetit të euros dhe për përcaktimin e kriterëve të kërkuara për vendet e BE -së, për të hyrë në zonën e euros. Banka Qendrore Evropiane është organi drejtues që mbikëqyr politikën e eurove. Selia e saj është e vendosur në Frankfurt, Gjermani. BQE punon ngushtë me Eurosistemin, i cili është një konglomerat i bankave qendrore të vendosura në Bashkimin Evropian që mbikëqyr printimin, prerjen dhe shpërndarjen e monedhave dhe kartëmonedhave të euros.



# KARTËMONEDHA EURO

Ekzistojnë dy seri kartëmonedhash.

Seria e parë përfshin shtatë emërtime të ndryshme: 5 €, 10 €, 20 €, 50 €, 100 €, 200 € dhe 500 €.

Seria e dytë ose seria Europa, përbëhet nga gjashtë emërtime dhe u përfundua me lëshimin në qarkullim të 100 € dhe 200 € më 28 maj 2019. Kartëmonedha 500 € nuk u përfshi në serinë Europa dhe që nga 27 prill 2019 nuk prodhohet më, por është në përdorim.



# DIZAJNI I KARTËMONEDHAVE


Dizajni i secilës kartëmonedhë ka një temë të përbashkët të arkitekturës evropiane të epokave të ndryshme artistike. Pjesa e përparme e kartëmonedhës përmban dritare ose porta hyrëse ndërsa pjesa e pasme përmban lloje të ndryshme urash. Shembujt arkitektonikë janë ilustrime të stilizuara dhe jo përfaqësime të monumenteve ekzistuese.





# ELEMENTET E DIZAJNIT TE KARTËMONEDHAT

1. **Emri i monedhës** - euro - si në alfabetin latin ashtu edhe në atë grek.
2. **Inicialet e Bankës Qendrore Evropiane** në pesë variante gjuhësore - BCE, ECB, EZB, EKT dhe EKP - që mbulojnë 11 gjuhët e atëhershme zyrtare të Bashkimit Evropian.
3. **Simboli ©** që tregon mbrojtjen e të drejtës së autorit.
4. **Nënshkrimi** i Presidentit të Bankës Qendrore Evropiane.
5. **Flamuri i Bashkimit Evropian**



# ELEMENTET E DIZAJNIT TE KARTËMONEDHAT (VAZHDIM)


## INICIALET E BANKËS QENDRORE EVROPIANE (BQE)

### Seria e parë (seria e vjetër)

Te të gjitha kartëmonedhat inicialet e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) janë në pesë variante gjuhësore.

### Seria e dytë (Seria Evropa)

Te kartëmonedhat 5€, 10€ dhe 20€ emri BQE është në nëntë variante gjuhësore  
Te kartëmonedhat: 50€, 100€ dhe 200€, emri BQE është në dhjetë variante gjuhësore.





# ELEMENTET E DIZAJNIT TE KARTËMONEDHAT (VAZHDIM)

## NËNSHKRIMI

Në kartemonedhat që janë në qarkullim mund të hasni në katër nënshkrime që janë nënshkrimet e katër presidentëve të BQE-së ndër vite.



# MONEDHA

Seria e monedhave euro përfshin tetë prerje të ndryshme: 2 €, 1 € , 50, 20, 10,5, 2,dhe 1 cent. Monedhat e euros kanë një anë të përbashkët dhe një anë kombëtare. Ana kombëtare tregon vendin lëshues. Anët e përbashkëta të monedhave u projektuan nga z. Luc Luycx nga Monedha Mbretërore Belgjike.

Monedhat tregojnë imazhe të Bashkimit Evropian ose të Evropës dhe simbolizojnë unitetin e BE -së. Monedhat 1, 2 dhe 5 cent tregojnë Evropën në raport (marrëdhëniet) me Afrikën dhe Azinë në glob. Monedhat euro, mund të përdoren kudo në zonën e euros.



# ELEMNETET E DIZAJNIT TE MONEDHAT

Ekzistojnë tetë prerje të monedhave euro, që variojnë nga një cent deri në dy euro.

- Monedha 2 euro është me dy ngjyra: e artë brenda, e argjendtë nga jashtë.
- Monedha 1 euro ka dy ngjyra, por në të kundërt: është e argjendtë brenda dhe e artë nga jashtë.
- Monedhat 50 cent, 20 cent dhe 10 cent të gjitha janë të arta.
- Ato prej 5 cent, 2 cent dhe 1 cent janë të gjitha me ngjyrë bakri.





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

**Adresa: Rr. Garibaldi nr. 33,**

**Prishtinë, Kosovë**

**[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)**

**E-mail: [info@bqk-kos.org](mailto:info@bqk-kos.org)**

**Telefon: +383 38 222 055**

**Fax: +383 38 243 763**